



Data: 11/09/2020 Ref.: 1572/20

Në mbështetje të nenit 4, dhe 23, të Ligjit për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës (nr.03/L-189, datë 16.09.2010), Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative (Nr. 05/L0031, datë 25.05.2016), nenit 7 dhe neni 15 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës (Nr. 04/L-037, datë 29.08.2011), Udhëzimin Administrativ Nr.15/2018 për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës, Udhëzimin Administrativ Nr. 02/2019, Nr. 08/2019 dhe Nr. 13/2019 për ndryshimin dhe plotësimin e Udhëzimit Administrativ Nr. 15/2018 për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës, Këshilli Shtetërorë i Cilësisë (KSHC), në mbledhjen e 83-të, të mbajtur më 02.09.2020, mori:

#### V E N D I M

- I. Akreditohet programi i studimit i Kolegjit Heimerer për periudhën tre vjeçare, 1 Tetor 2020 – 30 Shtator 2023:
  - Shkencat Shëndetësore për Profile Diagnostike - Teknik Laboratori (BSc), 180 ECTS, maksimum 40 student për vit akademik
- II. Obligohet Kolegji Heimerer që deri me datë 31 tetor 2020 të dorëzoj në Agjencinë e Kosovës për Akreditim (AKA) Planin e Implementimit të Rekomandimeve të dhëna në raportin final të ekspertëve ndërkombëtar të akreditimit
- III. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

## Arsyetimi

Kolegji Heimerer ka parashtruar kërkesë pranë Agjencisë së Kosovës për Akreditim (AKA) për riakreditim të programit të studimit të cekur në dispozitiv të këtij vendimi. AKA ka organizuar vizitën me ekspertë ndërkombëtarë të akreditimit në Kolegjin Heimerer, me qëllim të vlerësimit programin e studimit. Vizita është realizuar me ekspertët ndërkombëtarë të akreditimit me këtë përbërje: Danica Zeleznik dhe Delia Gologan

Sa i përket programit të studimit të cekura në dispozitivin I, ekspertët ndërkombëtarë kanë konstatuar se ky program i përmbush substancialisht kapitujt e standardeve të akreditimit të parapara në Manualin e Akreditimit dhe rrjedhimisht kanë rekomanduar dhënien e akreditimit.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi mund të paraqitet ankesë sipas Nenit 125 dhe 126 të Ligjit mbi Procedurën e Përgjithshme Administrative (Nr. 05/L-031, datë 25 Maj 2016). Ankesa kundër këtij akti administrativ i dorëzohet organit të Komisionit të Ankesave të AKA-së, sipas Rregullores nr. 2/2019, në afatin prej 30 ditëve nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ sipas Nenit 127 të LPPA.

Vendimi iu dërgohet:

- Kolegji Heimerer
- MASH;
- Arkivit të AKA-së.



Prof. Dr. Gazmend Luboteni  
Kryetar i Këshillit Shtetëror të Cilësisë